



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

*Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i Tehnologija--
Ministry of Education Science and Technology*

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet; 4, 21 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës dhe nenet 1 dhe 6 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4, shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive 22.03.2011, si dhe në bazë të konsultimeve me Këshillin Drejtues dhe menaxhmentin e UP-së, nxjerr :

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Mbajtja e zgjedhjeve në Universitetin e Prishtinës

NUMËR:06/2012

DATË:14.05.2012

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ, është krijimi i bazës ligjore për mbajtjen e zgjedhjeve studentore të UP-së dhe zgjedhjeve të përgjithshme të organeve dhe këshillave në njësi akademike të universitetit.

Neni 2 Zgjedhjet studentore të UP-së

1. Këshilli Drejtues i UP-së obligohet që të kujdeset për mbarëvajtjen e zgjedhjeve studentore në UP, të shpallura sipas rregullores për zgjedhje duke respektuar afatet dhe procedurat e zhvilluara sipas Vendimit të Këshillit Drejtues të datës: 04.04.2012, ref. nr. 854.
2. Këshilli Drejtues obligohet: 1) të përgatisë planin dinamik të zgjedhjeve studentore 2) të caktoj datën e zgjedhjeve në kohë të përshtatshme me qëllim të pjesëmarrjes sa më masive të studentëve në zgjedhje.

Neni 3
Zgjedhjet e përgjithshme në UP

1. Këshilli Drejtues i UP-së, obligohet që në afat prej 15 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi Administrativ:
 - 1.1 . Të shpallë zgjedhjet e përgjithshme në UP dhe këshillave në njësi akademike;
 - 1.2 . Të nxjerrë rregulloren për zgjedhjet në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë nr. 04/L-037, në frymën dhe qëndrimet e Senatit të shprehura në Statutin e ri;
 - 1.3 . Të përgatis planin dinamik të zgjedhjeve;
 - 1.4 . Të përfundojë zgjedhjet në UP në afat optimal dhe të arsyeshëm.
2. Të gjitha strukturat e dala nga zgjedhjet në UP, e marrin mandatin me 1 tetor 2012.

Neni 4
Dispozitat kalimtare

Strukturat e dala nga zgjedhjet në UP sipas këtij Udhëzimi administrativ, kanë mandat të plotë.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Ministri.


Prof. dr. Ramë Buja, ministër

